

MARS 2025

EKONOMIA DHE BUXHETI

Raport Mujor

EKONOMIA DHE BUXHETI

Raport Mujor

Mars 2025

© Ministria e Financave, 2025

Drejtoria e Përgjithshme e Programimit Makroekonomik dhe Fiskal
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Nr. 3, Tiranë

E-mail: Brixhilda.Nguli@financa.gov.al

Përmbajtja

VEÇORITË KRYESORE	2
--------------------------	----------

ZHVILLIMET EKONOMIKE	3
-----------------------------	----------

1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit	3
2. Kursi Mesatar i Këmbimit	4
3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave	5
4. Bilanci i Pagesave	6
5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar	7
6. Kredia për Ekonominë	8
7. Oferta e Parasë	9
8. Depozitat sipas Burimeve	10

SEKTORI FISKAL	11
-----------------------	-----------

1. Buxheti i Konsoliduar	11
2. Të Ardhurat Sipas Burimeve	12
3. Financimi i Bilancit Fiskal	12

ANEKSI STATISTIKOR	13
---------------------------	-----------

Veçoritë Kryesore

- Indeksi i çmimeve të konsumit, në mars 2025, arriti në 119.71. Norma vjetore e inflacionit për muajin mars 2025 ishte 2.1 përqind;
- Kursi mesatar i këmbimit të monedhës vendase me dy monedhat kryesore të huaja për muajin mars 2025 ishte 91.90 lekë për dollarë dhe 99.23 lekë për euro;
- Normat mesatare të interesit të depozitave në lekë sipas individëve dhe korporatave jofinanciare gjatë muajit mars 2025 shënuan normën 1.56 dhe 2.36 përqind;
- Normat mesatare të interesit të huave në lekë sipas individëve dhe korporatave jo-financiare gjatë muajit mars 2025 shënuan normën 6.00 dhe 6.02 përqind;
- Oferta totale e parasë, e matur nga agregati M3, arriti në rreth 1,810,140 milionë lekë në muajin mars 2025, duke shënuar një rritje prej rreth 7.1 përqind krahasuar me një vit më parë;
- Bilanci i përgjithshëm i pagesave për tremujorin e katërt të 2024 rezultoi pozitiv, në rritje të mjeteve të rezervës valutore, duke shënuar vlerën prej rreth 293.4 milionë euro;
- Situata buxhetore për periudhën janar-mars 2025 rezultoi me një suficit të përgjithshëm prej rreth 33.8 miliardë lekë, ndërkohë që ishte planifikuar një suficit prej 24.1 miliardë lekë;
- Të ardhurat gjithsej të realizuara për periudhën janar-mars 2025 arritën në rreth 181.1 miliardë lekë, ose afërsisht 10.2 përqind më shumë se muaji mars 2024 dhe 99.5 përqind realizim kundrejt planit të periudhës;
- Shpenzimet gjithsej gjatë së njëjtës periudhë arritën në rreth 147.4 miliardë lekë, ose rreth 11.7 përqind më shumë se muaji mars 2024 dhe 93.3 përqind realizim kundrejt planit të periudhës.

Zhvillimet Ekonomike

1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit


Inflacioni vjetor për muajin mars 2025 shënoi normën 2.1%, duke reflektuar një rënie në krahasim me një vit më parë kur ky ndryshim ishte 2.3%. Ndryshimi mujor i Indeksit të Çmimeve të Konsumit (IÇK) në muajin mars 2025, krahasuar me një muaj më parë, ka shënuar rritje me 0.6%. Inflacioni mesatar për periudhën janar-mars 2025 është 2.0%.

Nga tërësia e mallrave dhe shërbimeve që përbëjnë shportën e konsumit, grupet të cilat patën kontributin më të lartë në inflacionin e përgjithshëm ishin:

“Ushqime dhe pije joalkoolike” me rritje vjetore të çmimit prej +3.0%, duke kontribuar me +1.04 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +2.1%.

“Qera, ujë, lëndë djegëse dhe energji” me rritje vjetore të çmimit prej +0.9%, duke kontribuar me +0.17 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +2.1%.

“Mobilim, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje”, me rritje vjetore +3.5%, duke kontribuar me +0.26 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +2.1%.



“Pije alkoolike dhe duhan” me rritje vjetore të çmimit prej +4.4%, duke kontribuar me +0.22 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +2.1%.

“Mallra dhe shërbime të ndryshme” me rritje vjetore të çmimit prej +1.3%, duke kontribuar me +0.07 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +2.1%.

“Veshje dhe këpucë” me rritje vjetore të çmimit prej +3.0%, duke kontribuar me +0.11 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +2.1%.

“Hotele, kafene dhe restorante” me rritje vjetore të çmimit prej +1.9%, duke kontribuar me +0.10 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +2.1%.

Tab - 1 Ndryshimi vjetor i Indeksit të Çmimeve të Konsumit (në %)

VITI	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
2024	3.4	2.6	2.3	2.1	2.2	2.1	2.1	2.0	1.9	1.9	2.0	2.1
2025	2.0	1.9	2.1									

Burimi: INSTAT

2. Kursi mesatar i këmbimit


Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt euros në muajin mars 2025 arriti në 99.23 lekë/euro, duke u rritur me 0.20 përqind krahasuar me një muaj më parë. Në fund të muajit mars, një euro u këmbye me 99.29 lekë. Gjatë periudhës janar-mars 2025 kundrejt dhjetor 2024, vihet re një mbiçmim i lehtë i euros ndaj lekut në 0.6 përqind.

Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt dollarit amerikan në muajin mars 2025 arriti në 91.90 lekë/dollarë duke shënuar rënie me 3.36 përqind kundrejt një muaji më parë. Në fund të muajit mars, kursi i këmbimit për dollarin amerikan arriti në nivelin 92.15 lekë/dollarë. Gjatë periudhës janar-mars 2025 kundrejt dhjetor 2024, vihet re një mbiçmim i lehtë i dollarit ndaj lekut në 0.1 përqind.

Kursi i këmbimit të euros me dollarin amerikan shënoi një nivel mesatar rreth 0.93 dollarë/euro për muajin mars 2025.


Në krahasim me muajin mars të vitit të kaluar, pas një periudhe të konsiderueshme forcimi, rezulton se monedha shqiptare ka pësuar një mbiçmim ndaj monedhës europiane në masën 4.19 përqind, ndërsa kundrejt dollarit amerikan rezulton se është mbiçmuar në masën 3.59 përqind.

Presionet mbiçmuese mbi kursin e këmbimit janë moderuar në tremujorin e parë të vitit dhe leku është shfaqur i qëndrueshëm. Gjithashtu, stabilizimi i kursit të këmbimit të lekut ka ndikuar pozitivisht në kushtet e përgjithshme të financimit. Tregu valutor është karakterizuar nga stabiliteti i kursit të këmbimit të Lekut, rritja e vëllimeve të tregtimit dhe luhatshmëria e ulët.




3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave

Gjatë muajit mars 2025, normat mesatare të interesit të depozitave me afat në lekë sipas Individëve dhe Korporatave jofinanciare shënuan përkatësisht normat prej 1.56 dhe 2.36 përqind. Krahësuar me një muaj më parë, normat e interesit të depozitave sipas Individëve kanë shënuar rënie me 0.08 pikë përqindje, ndërsa për Korporatat jofinanciare janë rritur me 0.02 pikë përqindje. Ndërsa krahasuar me një vit më parë, normat e interesit të depozitave sipas Individëve kanë shënuar rënie me 0.58 pikë përqindje, ndërkohë që janë rritur me 0.30 pikë përqindje për Korporatat jofinanciare.



Normat e interesit të bonove të thesarit 12-mujore, për muajin mars 2025, kanë shënuar normën 2.72 përqind, nga 3.63 përqind që shënonte të njëjtën periudhë një vit më parë. Norma e bonos 12-mujore u ul me 0.06 pikë përqindje krahasuar me një muaj më parë dhe me 0.91 pikë përqindje krahasuar me një vit më parë.

Gjatë muajit mars 2025, normat mesatare të interesit të huave sipas Individëve dhe Korporatave jofinanciare shënuan normën 6.00 dhe 6.02 përqind. Krahësuar me një muaj më parë, normat e interesit të huave sipas Individëve u rritën me 0.15 pikë përqindje, ndërsa normat e interesit sipas Korporatave jofinanciare u ulën me 0.70 pikë përqindje. Ndërkohë, krahasuar me një vit më parë, normat e interesit të huave kanë shënuar rënie me 0.67 pikë përqindje për Individët dhe rënie me 0.37 pikë përqindje për Korporatat jofinanciare.





4. Bilanci i Pagesave T4-2024

Përgjatë vitit 2024, Bilanci i përgjithshëm i Pagesave rezultoi pozitiv, me rritje të mjetëve të rezervës valutore, duke shënuar vlerën 264 milionë euro, nga 937 milionë euro që ishte në vitin 2023. Gjithashtu, vetëm për tremujorin e katërt të 2024, BP shënoi vlerën rreth 293 milionë euro, krahasuar me tremujorin e katërt të 2023 që shënoi vlerën rreth 151 milionë euro.

Llogaria korrente u mbyll me balancë negative prej rreth 374 milionë euro, zgjeruar në terma vjetorë me rreth 133 milionë euro, në sfondin e përkeqësimit të deficitit tregtar në mallra. Përgjatë vitit 2024, Llogaria financiare dhe kapitale u ngushtua në vlerën +719 milionë euro, krahasuar me +1,048 miliardë euro në vitin 2023. Ndërsa, vetëm për tremujorin e katërt 2024, Llogaria Financiare dhe Kapitale u zgjerua në +605 milionë euro, krahasuar me +307 milionë euro në tremujorin e katërt 2023.

Investimet e huaja direkte u vlerësuan në +423 milionë euro ose +7.3 përqind më shumë, krahasuar me +394 mln euro në tremujorin e katërt të vitit 2023. Të ardhurat në formën e prurjeve valutore nga emigrantët shënuan +273 milionë euro, ose +8.2 përqind, krahasuar me +252 milionë euro në tremujorin e katërt të vitit 2023.

Stoku i rezervës valutore, në fund të dhjetorit 2024, shënon vlerën prej 6,264 milionë euro, mjaftueshëm për mbulimin e 7.0 muaj importe mesatare vjetore në mallra dhe shërbime dhe rreth 528% të borxhit të jashtëm afatshkurtër.





5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar

Gjatë muajit mars 2025, sistemi bankar ka shënuar rritje të mjeteve valutore neto (M.V.N) me rreth 102,423 milionë lekë krahasuar me muajin mars 2024. Kjo rritje ka ardhur kryesisht si pasojë e rritjes së mjeteve valutore neto në Bankën Qendrore me 101,686 milionë lekë. Krahasuar me një muaj më parë, mjetet valutore neto kanë shënuar rënie me 15,303 milionë lekë, ku më së shumti ka kontribuar rënia mujore prej 8,006 milionë lekë në Bankat Paradepozituese.

Oferta totale e parasë, e matur nga agregati M3, arriti në rreth 1,810,140 milionë lekë në muajin mars 2025, duke shënuar një rritje prej 119,480 milionë lekë krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, pra një rritje vjetore prej 7.1 përqind.

Në muajin mars, sistemi bankar rezulton me rënie mujore prej 2,668 milionë lekë, ose 0.1 përqind më pak krahasuar me muajin shkurt 2025.




6. Kredia për Ekonominë

Totali i kredisë për ekonominë në muajin mars 2025 arriti në rreth 864,977 milionë lekë. Bilanci i kredisë, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, shënoi rritje në vlerë me 101,388 milionë lekë, ose rritje me rreth 13.3 përqind. Struktura e kredisë sipas monedhave është e balancuar mes monedhës kombëtare (57.8%) dhe monedhave të huaja (42.2%).

Gjatë muajit mars 2025, zëri “Korporata të tjera jofinanciare”, zuri peshën më të lartë të totalit të kredive, me rreth 56.5 përqind ose 488,578 milionë lekë, ndjekur nga kreditë për Individë, ku pesha e tyre specifike arriti në nivelin 38.9 përqind ose rreth 336,616 milionë lekë. Zërat “Korporata jofinanciare publike” dhe “Korporata të tjera financiare” arritën respektivisht 2.2 dhe 2.4 përqind, apo 18,843 dhe 20,922 milionë lekë.


Për sa i përket shpërndarjes së kredisë sipas monedhës së huaj për muajin mars 2025, zëri “Korporata të tjera jofinanciare” zuri peshën më të lartë të kredive, me rreth 72.6 përqind, ndjekur nga “Sektorë të tjerë rezidentë” me rreth 22.5 përqind. “Korporata të tjera financiare” dhe “Korporata jofinanciare publike” kontribuojnë përkatësisht me 2.3 dhe 2.6 përqind secili.

Fig. 9



Rritja e stokut total të kredive Mars'25
Burimi: Banka e Shqipërisë

Fig. 10




Përbërja e kredive Mars'25
Burimi: Banka e Shqipërisë

7. Oferta e Parasë

Paraja jashtë Korporatave Depozituese arriti në rreth 429,642 milionë lekë në fund të muajit mars 2025. Raporti i Parasë jashtë Bankave me M3 në mars 2025 ka shënuar një rritje mujore prej 0.39 pikë përqindje dhe rritje vjetore prej 0.67 pikë përqindje, duke arritur nivelin 23.7 përqind. Raporti i Parasë jashtë Bankave me Depozitat ka shënuar rritje mujore prej 0.67 pikë përqindje dhe rritje vjetore prej 1.14 pikë përqindje, duke shënuar nivelin 31.1 përqind.


Fig. 11



Raportet e parasë jashtë bankave me M3 & Depozitat Mars'25
Burimi: Banka e Shqipërisë

Depozitat në valutë, si përbërësi kryesor i ofertës monetare për muajin mars 2025, kanë shënuar rritje vjetore prej 22,481 milionë lekë, e sjellë kryesisht nga depozitat për Individë, të cilat përbëjnë rreth 75.0 përqind të depozitave në valutë. Gjithashtu depozitat në Lekë, gjatë muajit mars 2025, shënuan rritje prej 57,323 milionë lekë në krahasim me muajin mars 2024. Sektori i Individëve në Lekë ka zënë 75.5 përqind të depozitave në lekë.

Fig. 12




Raporti i Depozitave ndaj M3 Mars'25
Burimi: Banka e Shqipërisë


Në muajin mars 2025, depozitat totale përbëjnë 76.3 përqind të agregatit M3, me një rënie rreth 0.7 pikë përqindje krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

8. Depozitat sipas Burimeve

Gjatë muajit mars 2025, zëri “Sektorë të tjerë rezidentë” zuri nivelin më të lartë të depozitave të transferueshme në lekë, me rreth 75.5 përqind, ndjekur nga “Korporata të tjera jofinanciare”, me rreth 17.6 përqind dhe nga “Korporata jofinanciare publike” me 4.5 përqind. “Sektorë të tjerë rezidentë” dhe “Korporata të tjera jofinanciare” ishin gjithashtu burimi më i rëndësishëm i depozitave në monedhë të huaj, përkatësisht me rreth 75.0 përqind dhe rreth 21.6 përqind. “Sektorë të tjerë rezidentë” ishin dukshëm burimi më i rëndësishëm i depozitave totale me rreth 75.2 përqind të totalit.



Në total, “Sektorë të tjerë rezidentë” përbëjnë pjesën më të madhe me rreth 1,038,651 milionë lekë të depozitave totale. Ato ndiqen nga “Korporata të tjera jofinanciare” (272,273 milionë lekë), “Korporata jofinanciare publike” (35,634 milionë lekë), “Korporata të tjera financiare” (26,809 milionë lekë) dhe “Qeveria lokale” me rreth 7,132 milionë lekë në totalin e depozitave. Gjatë muajit mars 2025, niveli i përgjithshëm i depozitave arriti vlerën rreth 1,380,498 milionë lekë. Krahasuar me një muaj më parë, niveli i depozitave shënoi rënie me rreth 9,134 milionë lekë. Ndërsa krahasuar me një vit më parë, totali i depozitave ka shënuar rritje me 79,803 milionë lekë.




Sektori Fiskal

1. Buxheti i Konsoliduar

Për periudhën janar-mars 2025 janë mbledhur rreth 181.1 miliardë lekë të ardhura, përkundrejt shpenzimeve të përgjithshme prej 147.4 miliardë lekë, ku pjesa më e madhe përfshin 139.1 miliardë lekë shpenzimet korrente, nga të cilat rreth 59.1 miliardë lekë shpenzime për fonde speciale.

Nga të ardhurat gjithsej, pjesa e të ardhurave të mbledhura nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (pa përfshirë kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore) dhe Doganave është rreth 123.4 miliardë lekë (99.3% realizim kundrejt planit të periudhës). Të ardhurat e mbledhura nga pushteti vendor janë rreth 6.0 miliardë lekë (73.1% realizim kundrejt planit të periudhës). Të ardhurat nga fondet speciale janë rreth 43.9 miliardë lekë (ose 3.1% më shumë se plani i periudhës) dhe të ardhurat jo-tatimore në nivelin 6.6 miliardë lekë (ose rreth 19.8% më shumë se plani i periudhës).



Nga totali i shpenzimeve korrente prej 139.1 miliardë lekë, 30.4 miliardë lekë (21.9% e totalit të shpenzimeve korrente) është shpenzuar për personelin, rreth 17.9 miliardë lekë (12.9% e totalit të shpenzimeve korrente) për shpenzime interesi, 10.2 miliardë lekë (7.3% e totalit të shpenzimeve korrente) për shpenzime operative dhe mirëmbajtje, 308 milionë lekë (0.2% e totalit të shpenzimeve korrente) për subvencione, 59.1 miliardë lekë (42.5%) për shpenzime për fonde speciale, 15.6 miliardë lekë (11.2% e totalit të shpenzimeve korrente) për shpenzimet e qeverisjes vendore, dhe 5.5 miliardë lekë (4.0% e totalit të shpenzimeve korrente) për shpenzime të tjera.

2. Të ardhurat sipas burimeve

Të ardhurat gjithsej të realizuara për periudhën janar-mars 2025 ishin rreth 181.1 miliardë lekë, nga të cilat të ardhurat tatimore rreth 173.2 miliardë lekë, të ardhurat jo-tatimore në rreth 6.6 miliardë lekë.

Tab - 2	Të ardhurat tatimore gjatë muajit Mars 2025 (mln Lekë)			
	Emërtimi	Mars'25	Mars'24	Mars'25/ Mars'24 Rritja në (%)
	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar	56,617	51,794	9.3
	Tatimi mbi Fitimin	17,392	18,651	-6.7
	Akcizat	14,574	13,054	11.6
	Tatimi mbi të Ardhurat Personale	20,748	15,288	35.7
	Taksa Nacionale dhe të tjera	12,015	10,988	9.3
	Taksa Doganore	2,045	1,987	2.9

Burimi: Ministria e Financave, Statistikat Fiskale: Prill 2025

3. Financimi i Bilancit Fiskal

Balanca buxhetore për periudhën janar-mars 2025 shënoi një vlerë pozitive prej rreth 33.8 miliardë lekë, ndërkohë që ishte planifikuar një suficit prej 24.1 miliardë lekë.

Për periudhën janar-mars 2025, disa nga treguesit kryesorë fiskalë ishin:

- Realizimi i të ardhurave në masën 181.1 miliardë lekë;
- Realizimi i shpenzimeve në masën 147.4 miliardë lekë.

Në realizimin e të ardhurave për periudhën janar-mars 2025, kontributin kryesor e kanë dhënë të ardhurat tatimore, të cilat arrijnë shifrën e 173.2 miliardë lekë. Në realizimin e shpenzimeve për këtë periudhë, peshën më të lartë e zënë shpenzimet korrente me 139.1 miliardë lekë dhe shpenzimet për fonde speciale me rreth 59.1 miliardë lekë.

Aneksi Statistikor

Tab - 1

Muaji	Mujor (Monthly)					Mesatar Mujor (Monthly Average)					Vjetor (Annual)					Month
	2021	2022	2023	2024	2025	2021	2022	2023	2024	2025	2021	2022	2023	2024	2025	
Janar	1.3	1.3	1.1	0.5	0.4	1.3	1.3	1.1	0.5	0.4	0.4	3.7	7.2	3.4	2.0	January
Shkurt	1.1	1.3	1.1	0.3	0.3	1.2	1.3	1.1	0.4	0.4	1.1	3.9	7.1	2.6	1.9	February
Mars	0.7	2.4	0.7	0.4	0.6	1.0	1.7	1.0	0.4	0.4	1.2	5.7	5.3	2.3	2.1	March
Prill	0.2	0.7	0.03	-0.2		0.8	1.4	0.9	0.3		1.9	6.2	4.6	2.1		April
Maj	-0.9	-0.5	-0.3	-0.2		0.5	1.0	0.7	0.2		1.8	6.7	4.7	2.2		May
Qershor	-0.8	-0.1	-0.3	-0.4		0.3	0.9	0.6	0.4		1.6	7.4	4.5	2.1		June
Korrik	0.1	0.2	-0.1	-0.2		0.2	0.8	0.5	0.3		2.2	7.5	4.2	2.1		July
Gusht	0.4	0.8	0.6	0.5		0.3	0.8	0.5	0.3		2.4	8.0	4.0	2.0		August
Shtator	0.5	0.6	0.7	0.6		0.3	0.7	0.4	0.3		2.5	8.1	4.1	1.9		September
Tetor	0.1	0.4	0.1	0.1		0.3	0.7	0.4	0.3		2.4	8.3	3.8	1.9		October
Nëntor	0.2	-0.3	-0.2	0.0		0.3	0.6	0.3	0.1		3.1	7.9	3.9	2.0		November
Dhjetor	0.8	0.4	0.5	0.6		0.3	0.6	0.3	0.2		3.7	7.4	4.0	2.1		December

Burimi : INSTAT

Source : INSTAT

Tab - 2 **Kursi i këmbimit**
Exchange rate

Monedha	2021	2022	2023	2024	2025 Janar January	2025 Shkurt February	2025 Mars March	Currency
Mesatarja e periudhës								Average of period
USD	103.68	113.04	100.65	93.09	95.09	95.10	91.90	USD
EURO	122.37	118.98	108.80	100.71	98.51	99.03	99.23	EURO
Fundi i periudhës								In the end of period
USD	106.54	107.05	93.94	94.26	96.14	95.41	92.15	USD
EURO	120.76	114.23	103.88	98.15	99.80	99.23	99.29	EURO

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

Tab - 3

Normat e interesit me bazë vjetore (në Lek)*Annual Interest Rates (in ALL)*

Në përqindje	2025 Janar January	2025 Shkurt February	2025 Mars March	In percent
<i>Norma e interesit të depozitave për individët</i>				<i>Interest rates on households deposits</i>
Deri në 1 vit	1.30	1.26	1.25	Up to 1 year
Nga 1-2 vite	2.47	2.29	1.78	From 1 to 2 years
Mbi 2 vjet	2.67	2.57	2.66	Over 2 years
<i>Norma e interesit të depozitave për korporatat jofinanciare</i>				<i>Interest rates on nonfinancial corporations deposits</i>
Deri në 1 vit	2.46	2.35	2.28	Up to 1 year
Nga 1-2 vite	2.97	3.09	3.20	From 1 to 2 years
Mbi 2 vjet	3.20	2.16	3.75	Over 2 years
<i>Normat e interesit të kredive për individët</i>				<i>Interest rates on household loans</i>
Kredi për banesa	3.58	3.82	3.64	Lending for house purchase
Kredi konsumatore	8.21	7.96	8.54	Consumer credit
Kredi për qëllime të tjera	8.46	11.21	10.71	Credit for other purposes
<i>Normat e interesit të kredive për korporatat jofinanciare</i>				<i>Interest rates on nonfinancial corporations loans</i>
Kredi deri në 140 milionë lekë	6.89	6.81	6.67	Loans up to to an amount of 140 millions of lek
Kredi mbi 140 milionë lekë	5.92	6.35	5.52	Loans over an amount of 140 millions of lek
<i>Norma e letrave me vlerë</i>				<i>Securities rates</i>
Bono thesari 1/				Treasury bills 1/
3-M	-	2.60	-	3-M
6-M	-	-	2.63	6-M
12-M	2.78	2.78	2.72	12-M

Burimi: Banka e Shqipërisë**Source:** Bank of Albania

TREGUESIT FISKAL SIPAS BUXHETIT TË KONSOLIDUAR 2025

Fiscal indicators regarding consolidated budget of 2025

Të dhëna progresive (Progressive Data)

në milionë Lek (in million ALL)

Nr.	E M Ë R T I M I	January Janar	February Shkurt	March Mars	ITEMS
	TOTALI TË ARDHURAVE	64,610	116,867	181,106	TOTAL REVENUE
I.	Të ardhura nga ndihmat	1,326	919	1,267	Grands
II.	Të ardhura tatimore	60,760	111,217	173,245	Tax Revenue
II.1	Nga Tatimet dhe Doganat	42,637	77,740	123,393	From tax offices and customs
1	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar	22,020	38,614	56,617	V.A. T
2	Tatimi mbi Fitimin	2,964	6,402	17,392	Profit Tax
3	Akcizat	4,867	9,466	14,574	Excise Tax
4	Tatimi mbi të Ardhurat Personale	7,277	13,549	20,748	Personal Income Tax
5	Taksa Nacionale dhe të tjera	4,923	8,461	12,015	National Taxes and others
6	Taksa Doganore	586	1,248	2,045	Customs Duties
II.2	Të ardhura nga Pushteti Vendor	1,855	3,406	5,971	Revenues from Local Gov.
1	Taksë mbi Pasurinë (ndërtesat)	406	813	1,426	Property Tax
2	Taksë mbi Biznesin e vogël	1	6	12	Small Business Tax
3	Taksa Lokale	1,448	2,586	4,533	Local Taxes
II.3	Të ardhura nga fondet speciale	16,267	30,072	43,881	Social ins. contributions
1	Sigurimi Shoqëror	14,011	25,992	37,971	Social Insurance
2	Sigurimi Shëndetësor	2,200	3,962	5,712	Health insurance
3	Të ardhura për kompensim në vlerë të pronarëve	56	118	198	Compensation income in the value of owners
III.	Të ardhura Jotatimore	2,525	4,730	6,594	Nontax Revenue
1	Tran.Fitimi nga Banka e Shqipërisë	0	0	0	Profit transfer from BOA
2	Të ardhura nga Inst.Buxhetore	1,139	2,526	3,509	Income of budgetary institutions
3	Tarifat shërbimeve	306	544	774	Utility fees
4	Të tjera	1,081	1,660	2,311	Others
	TOTAL I SHPENZIMEVE	46,460	93,880	147,351	TOTAL EXPENDITURE
I.	Shpenzime Korrente	44,554	90,721	139,103	Current Expenditures
I.1	Personeli	9,987	20,229	30,444	Personnel expenditures
1	Paga	8,552	17,351	26,101	Wages
2	Kontributi për Sigurime Shoqërore	1,425	2,847	4,272	Social insurance contributions
3	Arsimi i lartë nga të ardhurat e veta	10	31	71	Higher education from its own income
I.2	Interesat	8,865	13,451	17,919	Interest
1	Të Brendshme	7,536	11,607	14,726	Domestic
2	Të Huaja	1,329	1,844	3,193	Foreign
I.3	Shpenzime Operative Mirëmbajtje	2,121	5,913	10,214	Operational & Maintenance
I.4	Subveconet	35	187	308	Subsidies
I.5	Shpenzime për fonde speciale	18,166	38,363	59,130	Social Insurance outlays
1	Sigurime Shoqërore	14,445	29,064	45,401	Social insurance
2	Sigurime Shëndetësore	3,715	9,131	13,564	Health insurance
3	Fondi i kompensimit të pronarëve	6	168	165	Owners' Compensation Fund
I.6	Shpenzime për Buxhetin Vendor	3,944	9,263	15,575	Local budget expenditure
I.7	Shpenzime të tjera	1,436	3,314	5,512	Other expenditures
1	Pagesa e Papunesisë	55	111	168	Unemployment insurance benefits
2	Ndihma Ekonomike	1,381	3,200	5,149	Economic Aid
3	Kompensim për ish të përndjekurit politike	0	3	95	Birth bonus
I.8	Transferime Kapitale	0	0	0	Capital transfers
II	Fondi Rezerve, Kontigjenca	0	0	0	Reserve fund/contingency
III	Shpenzime Kapitale	1,906	3,159	8,248	Capital expenditures
1	Financimi i Brendshëm	0	202	3937	Domestically financing
2	Investime nga të ardhurat e Arsimit të Lartë	0	31	100	From higher education system's own revenues
3	Financimi i Huaj	1,906	2,925	4,028	Foreign financed
IV	Fondi i rindërtimit	0	2	183	Reconstruction fund
V.	DEFICITI	18,150	22,987	33,754	CASH BALANCE
V.1	FINANCIMI DEFICITIT	-18,150	-22,987	-33,754	CASH BALANCE FINANCING
V.2	Brendshëm	-14,684	-81,214	-92,432	Domestic
1	Të ardhura nga privatizimi	1	226	236	Privatization receipts
2	Hua-marrje e brendshme	-5,044	-6,915	-6,535	Domestic new borrowing (net)
3	Të tjera	-9,641	-74,525	-86,133	Others
V.3	I huaj	-3,466	58,226	58,677	Foreign
1	Hua afatgjatë(e marrë)	680	64,682	65,448	Long-term foreign borrowing (gross)
2	Ndryshimi i gjendjes së arkës*	-63	476	541	Chang. of stat. Account
3	Ripagesat	-4,083	-6,932	-10,283	Repayments
4	Mbështetje Buxhetore	0	0	2972	Budgetary Support

Burimi : Ministria e Financave

Source : Ministry of Finance

* "Ndryshimi i gjendjes së arkës" përfaqëson ndryshimin e Depozitës së Financimeve të Huaja.

Tab - 5

Tabela e investimeve 2025

Table of investments 2025

Të dhëna progresive (Progresive Data)

në milionë Lek (in million ALL)

	Janar January	Shkurt February	Mars March	
Financim i brendshëm	-14,684	-81,214	-92,432	Domestic financing
Në %	80.9	353.3	273.8	In %
Financim i huaj	-3,466	58,226	58,677	Foreign financing
Në %	19.1	-253.3	-173.8	In %
Totali	-18,150	-22,987	-33,754	Total
Në %	100	100	100	In %

Burimi: Ministria e Financave

Source: Ministry of Finance

Tab - 6 TË ARDHURAT DOGANORE DHE TATIMORE 2025
CUSTOMS AND TAX REVENUES 2025

Të dhëna progresive (Progresive Data)

në milionë Lek (in million ALL)

	Janar January	Shkurt February	Mars March	
TË ARDHURAT DOGANORE 2025 (CUSTOMS REVENUE)				
Taksë doganore	586	1,248	2,045	Customs Duties
TVSH	10,745	22,522	35,544	V.A.T
Akcizë	4,867	9,466	14,574	Excises
Të tjera (Renta Minerare)	184	406	634	Others (Mineral Rent)
TOTALI	16,383	33,641	52,797	Total
TË ARDHURAT TATIMORE 2025 (TAX REVENUE)				
TVSH	11,275	16,092	21,073	V.A.T
Tatim mbi fitimin	2,964	6,402	17,392	Profit Tax
Tatimi mbi të ardhurat personale	7,277	13,549	20,748	Personal income tax
Taksa nacionale dhe të tjera	4,738	8,056	11,382	National taxes
TOTALI	26,254	44,099	70,596	Total
TOTALI I PËRGJITHSHËM	42,637	77,740	123,393	OVERALL TOTAL

Burimi: Ministria e Financave

Source: Ministry of Finance

Tab - 7

DEFICITI DHE FINANCIMI PËR 2025

*The Deficit and Its Financing for 2025**Të dhëna progresive (Progresive Data)**në milionë Lek (in million ALL)*

	Janar January	Shkurt February	Mars March	
TË ARDHURAT	64,610	116,867	181,106	REVENUE
SHPENZIMET	46,460	93,880	147,351	EXPENDITURES
BILANCI FISKAL	18,150	22,987	33,754	FISCAL BALANCE
FINANCIMI I BILANCIT FISKAL	-18,150	-22,987	-33,754	FINANCING
Financimi i brendshëm	-14,684	-81,214	-92,432	Domestic
Të ardhura nga privatizimi	1	226	236	Privatization receipts
Hua-marrje e brendshme	-5,044	-6,915	-6,535	Domestic borrowing
Të tjera	-9,641	-74,525	-86,133	Others
Financimi i jashtëm	-3,466	58,226	58,677	Foreign
a. Hua afatgjatë (e marrë)	680	64,682	65,448	Long-term foreign borrowing (gross)
b. Ndryshimi i gjendjes së arkës*	-63	476	541	Chang. of stat. Account
c. Ripagesat	-4,083	-6,932	-10,283	Repayments
d. Mbështetje Buxhetore			2,972	Budgetary Support

Burimi: Ministria e Financave**Source:** Ministry of Finance

BILANCI I PAGESAVE

Balance of payments

Në milionë Euro

In millions Euro

	2021	2022	2023	2024	T1-2024	T2-2024	T3-2024	T4-2024	
Llogaria korrente	-1,166.43	-1,063.27	-263.76	-607.00	-357.50	-221.40	346.34	-374.44	Current Account.
Bilanci tregtar	-3,829.34	-4,268.90	-4,539.87	-5,592.91	-1,236.16	-1,354.94	-1,455.36	-1,546.45	Trade Balance.
Eksporti I mallrave fob	1,264.79	1,932.53	1,836.09	1,678.80	389.57	488.26	407.71	393.26	Merchandise Exports. Fob
Importi I mallrave fob	5,094.13	6,201.43	6,375.96	7,271.71	1,625.73	1,843.21	1,863.07	1,939.70	Merchandise Imports. Fob
Bilanci i shërbimeve	1,795.85	2,401.33	3,357.78	3,875.55	629.06	864.17	1,496.00	886.32	Services Balance.
Shërbimet Kredi	3,485.79	4,801.38	6,571.65	7,409.82	1,365.22	1,738.69	2,587.54	1,718.38	Services Credit
Shërbimet Debi	1,689.93	2,400.05	3,213.87	3,534.27	736.15	874.52	1,091.54	832.06	Services Debt
Bilanci i të ardhurave	-210.93	-314.76	-278.45	-191.09	-47.05	-69.05	-24.04	-50.95	Balance of Incomes
Të ardhurat Kredi	397.62	596.79	771.30	958.77	217.87	240.89	264.20	235.82	Income Credit
Të ardhurat Debi	608.55	911.55	1,049.75	1,149.85	264.91	309.93	288.24	286.76	Income Debt
Bilanci i transfertave	1,077.97	1,119.05	1,196.77	1,301.44	296.64	338.42	329.74	336.64	Balance of Transfers
Transferta private	1,244.02	1,280.21	1,367.95	1,507.51	344.39	386.93	382.07	394.11	Private Unrequired Transfers
Transferrat shtetërore	166.05	161.16	171.18	206.07	47.75	48.51	52.33	57.47	Official Unrequired Transfers
Llogaria kapitale	359.26	20.14	45.81	-156.44	-74.74	-65.25	-60.13	43.68	Capital Account
Llogaria financiare	-1,564.51	-819.19	-1,002.34	-875.55	-136.89	-211.90	34.19	-560.95	Financial Account
Investime direkte	-989.93	-1,189.95	-1,255.64	-1,343.68	-282.53	-325.18	-353.68	-382.29	Direct Investment
Investime portofoli	-96.46	573.11	325.01	416.44	159.26	-42.81	118.18	181.82	Portfolio Investment
Investime të tjera	-531.66	-264.84	-175.23	-89.91	-54.64	123.59	228.92	-387.77	Other Capital
Gabime dhe harresa neto	178.83	154.14	152.42	151.60	15.26	-42.04	115.15	63.24	Net errors and omissions
Bilanci i përgjithshëm	936.17	-69.80	936.81	263.71	-280.09	-116.79	367.17	293.43	Overall Balance
Rezervat	936.17	-69.80	936.81	263.71	-280.09	-116.79	367.17	293.43	Reserve Assets
Përdor kred & huash nga FMN	-53.54	-62.48	-103.53	-141.59	-41.03	-32.50	-40.77	-27.29	Use of Fund Credit and Loans

Burimi: Banka e Shqipërisë

Source: Bank of Albania

MJETET VALUTORE NETO

Net Foreign Assets

Në milionë Lekë Fundi i periudhës	2021	2022	2023	2024	2025 Janar January	2025 Shkurt February	2025 Mars March	Millions of Lek End of Period
Mjete valutore neto	937,814	892,687	974,610	1,016,857	1,032,091	1,088,704	1,073,401	Net foreign assets
Pretendime ndaj jorezidentëve	1,027,069	981,133	1,054,373	1,101,474	1,116,800	1,173,656	1,158,517	Claims on nonresidents
Minus Detyrime të jorezidentëve	89,255	88,446	79,763	84,617	84,709	84,952	85,116	Minus: Liabilities to nonresidents
Mjetet e brendshme	1,084,106	1,211,348	1,218,505	1,325,858	1,373,042	1,314,548	1,328,924	Domestic assets
Pretendimet neto ndaj qeverisë qendrore	412,253	491,750	467,994	484,020	525,064	459,933	456,880	Net claims on central government
Pretendime ndaj sektorëve të tjerë	671,852	719,598	750,511	841,838	847,977	854,615	872,044	Claims on other sectors
Detyrimet e parasë së gjerë	1,582,310	1,659,293	1,698,232	1,784,762	1,819,051	1,812,808	1,810,140	Broad Money liabilities
Paraja jashtë Korporatave Depozituese	366,251	387,652	393,555	423,556	422,058	423,176	429,642	Money outside depository corporations
Depozita të transferueshme	584,631	645,637	689,496	727,641	754,088	747,450	733,310	Transferable deposits
Depozita të tjera	631,428	626,005	615,181	633,565	642,905	642,182	647,187	Other deposits
Depozita të papërfshira në paranë e gjerë	222,409	248,219	297,573	330,097	338,749	338,993	340,624	Deposits excluded from Broad Money
Qeveria lokale dhe administrata publike								Local government and public administration
Korporata të tjera financiare	5,877	7,250	8,018	11,289	11,538	10,497	9,638	Other financial corporations
Korporata jofinanciare publike	392	382	338	464	502	592	596	Public nonfinancial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	16,599	10,186	14,936	19,479	22,707	22,059	22,602	Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	199,541	230,401	274,281	298,865	304,003	305,845	307,789	Other resident sectors
Letrat me vlerë të ndryshme nga aksionet	7,288	7,925	13,331	20,320	20,520	20,478	20,047	Securities other than shares
Korporata të tjera jofinanciare	67	291	614	1,167	1,171	1,168	1,120	Korporata të tjera jofinanciare
Sektorë të tjerë rezidentë	7,221	7,634	12,717	19,153	19,349	19,310	18,928	Other resident sectors
Huatë	3,507	4,636	5,880	4,896	13,227	10,141	10,210	Loans
Qeveria lokale dhe administrata publike								Local government and public administration
Korporata të tjera financiare	3,507	4,636	5,880	4,896	13,227	10,141	10,210	Other financial corporations
Korporata jofinanciare publike								Public nonfinancial corporations
Korporata të tjera jofinanciare								Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë								other resident sectors
Llogari të pagueshme	248	86	110	42	41	87	24	Accounts payable
Korporata të tjera financiare								Other financial corporations
Korporata jofinanciare publike								Public nonfinancial corporations
Korporata të tjera jofinanciare		69	0	0	2	7	1	Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	247	17	110	42	39	79	24	other resident sectors
Aksione dhe instrumenta të tjerë të kapitalit	219,725	185,627	191,673	215,459	231,463	237,241	229,901	Shares and other equity
Nga të cilat rezerva rivlerësimi	-5,442	-46,110	-73,603	-76,032	-64,595	-63,315	-56,437	Of which: Valuation adjustment
Të tjera neto	-14,428	-12,607	-15,143	-16,391	-19,117	-17,624	-10,507	Other items net
Detyrime të tjera	59,094	63,859	63,848	67,545	65,307	65,685	72,066	Other liabilities
Minus: Mjete të tjera	73,521	76,467	78,990	83,936	84,423	83,309	82,574	Minus: Other assets
Axhustimi i konsolidimit	862	4,826	1,459	3,529	1,198	1,130	1,886	Consolidation adjustment

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

Tab -
10 **KREDIA PËR EKONOMINË**
Credit to Economy

Në milionë Lekë Fundi i periudhës	2021	2022	2023	2024	2025 Janar January	2025 Shkurt February	2025 Mars March	Millions of Lek End of Period
Totali i kredisë	666,178.4	713,552	744,162.7	834,768.4	840,906.8	847,547.2	864,976.8	Total Credit
Kredia për qeverinë lokale dhe administratën publike	313.2	205	103.0	23.9	22.3	20.6	18.9	Credits to local Government
Në lekë	313.2	204.79	103.0	23.9	22.3	20.6	18.9	in Lek
Në valutë	-	0	0	0.0	0	0	0	in Foreign Currency
Kredia për korporatat jofinanciare publike	22,521.8	23,714	16,754.0	18,958.8	17,715.8	18,316.0	18,842.7	Credits to Public Non-financial Corporations
Në lekë	9,210.6	10,509	9,247.1	7,354.1	6,579.2	6,801.5	9,227.9	in Lek
Në valutë	13,311.3	13,205	7,506.9	11,604.7	11,136.6	11,514.5	9,614.8	in Foreign Currency
Kredia për korporatat e tjera jofinanciare	395,162.7	411,853	421,985.1	469,926.0	474,072.8	476,570.7	488,577.5	Credits to other Non-financial Corporations
Në lekë	172,000.2	173,607	196,936.3	216,945.6	215,340.3	218,396.9	223,735.5	in Lek
Në valutë	223,162.5	238,246	225,048.8	252,980.4	258,732.5	258,173.8	264,842.0	in Foreign Currency
Kredia për korporatat e tjera financiare	13,815.7	15,557	19,468.4	22,212.3	21,710.9	21,063.8	20,921.6	Credits to Other Financial Corporations
Në lekë	7,772.8	8,669	12,411.3	14,719.3	13,834.2	12,954.3	12,598.1	in Lek
Në valutë	6,043.0	6,888	7,057.0	7,493.0	7,876.8	8,109.5	8,323.5	in Foreign Currency
Kredia për sektorë të tjerë rezidentë	234,365.0	262,223	285,852.2	323,647.4	327,385.0	331,576.3	336,616.3	Credits to other resident sectors
Në lekë	158,093.0	175,901	204,247.5	244,028.1	245,643.7	249,701.9	254,442.5	in Lek
Në valutë	76,272.0	86,322	81,604.7	79,619.3	81,741.3	81,874.4	82,173.8	in Foreign Currency

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

OFERTA E PARASË

Money Supply

Mujor-Monthly

Në milionë Lekë	2021	2022	2023	2024	2025 Janar	2025 Shkurt	2025 Mars	Millions of Lek End of Period
Fundi i perludhës					January	February	March	
Baza monetare	565,163	619,187	632,446	613,646	623,138	630,121	617,356	Monetary base
Paraja jashtë korporatave depozituese	366,251	387,652	393,555	423,556	422,058	423,176	429,642	Currency outside depository corporations
Agregati M1	701,404	735,839	772,513	845,677	865,423	861,261	865,301	M1 Aggregate
Agregati M2	918,474	939,309	972,613	1,052,575	1,073,369	1,070,491	1,074,843	M2 Aggregate

Burimi : Banka e Shqipërisë**Source** : Bank of Albania

DEPOZITAT

Deposits

Mujor-Monthly

Në milionë Lekë Fundi i periudhës	2021	2022	2023	2024	2025 Janar January	2025 Shkurt February	2025 Mars March	Millions of Lek End of Period
Totali i depozitave	1,216,059	1,271,642	1,304,677	1,361,206	1,396,993	1,389,632	1,380,498	
Në lekë	552,223	551,657	579,058	629,019	651,311	647,315	645,201	
Depozitat e transferueshme	276,074	291,263	323,847	362,855	385,521	379,536	375,964	Transferable deposits
Qeveria lokale dhe administrata publike	1,302	1,694	2,000	3,536	3,442	3,328	3,380	Local governments and public administration
Korporata jofinanciare publike	17,118	16,031	21,228	22,175	25,453	24,117	24,038	Public nonfinancial corporations
Korporata të tjera financiare	4,744	7,045	5,133	5,818	5,620	6,187	5,217	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	77,758	77,667	91,605	96,156	112,226	105,149	100,017	Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	175,154	188,826	203,881	235,169	238,779	240,754	243,312	Other resident sectors
Depozita me likuiditet të lartë (Depozita pa afat)	59,079	56,924	55,111	59,266	57,843	58,549	59,695	Liquid deposits (Sight deposits)
Qeveria lokale dhe administrata publike								Local governments and public administration
Korporata jofinanciare publike	1,762	2,636	1,669	3,535	975	813	948	Public nonfinancial corporations
Korporata të tjera financiare	78	37	46	1	1	0	15	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	3,554	2,493	3,745	3,821	4,033	4,331	4,425	Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	53,686	51,758	49,651	51,909	52,835	53,406	54,307	Other resident sectors
Depozita të tjera	217,070	203,470	200,101	206,898	207,947	209,230	209,542	Other deposits
Qeveria lokale dhe administrata publike				1,003	1,007	1,006	1,004	Local governments and public administration
Korporata jofinanciare publike	757	598	2,656	3,901	4,052	4,463	3,762	Public nonfinancial corporations
Korporata të tjera financiare	5,136	5,114	5,386	5,659	5,557	5,435	5,975	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	7,598	6,379	9,553	9,789	8,860	9,149	9,226	Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	203,579	191,379	182,506	186,545	188,470	189,177	189,575	Other resident sectors
Në valutë	663,836	719,985	725,619	732,187	745,682	742,317	735,297	In foreign currency
Depozitat e transferueshme	308,556	354,374	365,649	364,787	368,567	367,914	357,346	Transferable deposits
Qeveria lokale dhe administrata publike	39	76	154	106	101	120	144	Local governments and public administration
Korporata jofinanciare publike	2,465	3,901	4,128	3,967	4,135	4,498	3,638	Public nonfinancial corporations
Korporata të tjera financiare	6,143	6,598	5,425	5,416	4,820	6,421	5,667	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	116,544	136,911	148,159	144,201	142,289	138,925	130,733	Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	183,366	206,889	207,783	211,098	217,222	217,950	217,164	Other resident sectors
Depozita me likuiditet të lartë (Depozita pa afat)	136,407	139,409	129,272	126,200	128,696	128,712	128,155	Liquid deposits (Sight deposits)
Qeveria lokale dhe administrata publike					2	1	1	Local governments and public administration
Korporata jofinanciare publike	94	101	6	6	6	6	6	Public nonfinancial corporations
Korporata të tjera financiare	10	1	0	0	0	15	13	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	3,739	4,702	6,408	5,970	5,760	5,965	5,628	Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	132,565	134,605	122,856	120,222	122,928	122,725	122,506	Other resident sectors
Depozita të tjera	218,873	226,202	230,698	241,200	248,419	245,690	249,796	Other deposits
Qeveria lokale dhe administrata publike	24	984	219	2,571.8	2,620	2,609	2,601	Local governments and public administration
Korporata jofinanciare publike	1,519	2,607	2,923	2,374	2,444	2,250	3,242	Public nonfinancial corporations
Korporata të tjera financiare	8,936	7,561	8,174	10,107	10,825	9,093	9,922	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	12,622	23,903	22,444	19,474	19,229	20,373	22,244	Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	195,771	191,147	196,937	206,674	213,302	211,366	211,787	Other resident sectors

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

Tregues të shëndetit financiar (FSI)

(në përqindje)

Financial Soundness Indicators (FSI)

(in percentage)

Përshkrimi i treguesit	Janar'25	Shkurt'25	Mars'25	Indicator's description
Tregues me bazë kapitalin				Capital-based
Kapitali rregullator ndaj aktiveve të ponderuara me rrezik (në %)	-	-	19.50	Regulatory capital as a percent of risk-weighted assets (in %)
Kapitali rregullator (mln lekë)	-	-	209,304.14	Regulatory capital (million lek)
Aktive të ponderuara me rrezik (mln lekë)	-	-	1,073,606.02	Risk-weighted assets
Kapitali rregullator i nivelit I ndaj aktiveve të ponderuara me rrezik (në %)	-	-	17.87	Regulatory Tier 1 capital as a percent of risk-weighted assets (in %)
Kapitali ndaj totalit të aktiveve				Capital as a percent of total assets
Kapitali rregullator i nivelit I ndaj totalit të aktiveve	8.98	8.92	9.05	Regulatory Tier 1 capital as a percent of total assets
Kapitali rregullator ndaj totalit të aktiveve (në %)	9.79	9.71	9.87	Regulatory capital as a percent of total assets (in %)
Kapitali aksioner ndaj totalit të aktiveve (në %)	10.30	10.41	10.27	Shareholders' equity as a percent of total assets (in %)
Huatë me probleme neto nga provigjonet ndaj kapitalit (në %)				Nonperforming loans net of provisions as a percent of capital (in %)
Huatë me probleme neto nga provigjonet ndaj kapitalit rregullator të nivelit I (në %)	4.26	4.61	5.03	Nonperforming loans net of provisions as a percent of regulatory Tier1 capital (in %)
Huatë me probleme neto nga provigjonet ndaj kapitalit rregullator (në %)	3.90	4.23	4.61	Nonperforming loans net of provisions as a percent of regulatory capital (in %)
Huatë me probleme neto nga provigjonet ndaj kapitalit aksioner (në %)	3.71	3.95	4.43	Nonperforming loans net of provisions as a percent of shareholders' equity (in %)
Kthimi nga kapitali (ROE) (bazë vjetore) (në %)	19.18	18.84	15.47	Return on equity (ROE) (annual basis) (in %)
Pozicioni i hapur neto në valutë ndaj kapitalit (në %)				Net open position in foreign exchange as a percent of capital (in %)
Pozicioni i hapur neto në valutë ndaj kapitalit rregullator të nivelit I (në %)	5.01	6.58	5.53	Net open position in foreign exchange as a percent of regulatory Tier 1 capital (in %)
Pozicioni i hapur neto në valutë ndaj kapitalit rregullator (në %)	4.59	6.04	5.07	Net open position in foreign exchange as a percent of regulatory capital (in %)
Pozicioni i hapur neto në valutë ndaj kapitalit aksioner (në %)	4.37	5.64	4.87	Net open position in foreign exchange as a percent of shareholders' capital (in %)
Tregues me bazë aktivet				Asset-based indicators
Aktive likuide ndaj totalit të aktiveve (metoda e gjerë)	30.64	30.49	29.11	Liquid assets as a percent of total assets (broad measure)
Aktive likuide ndaj totalit të aktiveve (metoda bazë)	29.50	29.43	28.50	Liquid assets as a percent of total assets (core measure)
Aktive likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra (deri në një vit) (metoda e gjerë)	43.59	43.37	41.62	Liquid assets as a percent of short-term liabilities (broad measure)
Aktive likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra (deri në një vit) (metoda bazë)	41.96	41.87	40.74	Liquid assets as a percent of short-term liabilities (core measure)
Kthimi nga aktivet (ROA) (bazë vjetore) (fitimi neto para taksave)	2.33	2.27	1.88	Return on assets (ROA) (annual basis) (net profit before taxes)
Huatë me probleme (bruto) ndaj totalit të huave (në %)	4.12	4.06	4.02	Nonperforming loans (gross) as a percent of total loans (in %)
Tregues të të ardhurave dhe shpenzimeve				Income and expense-based
Marzhi i interesave ndaj të ardhurave bruto	74.89	75.30	77.48	Interest margin to gross income
Shpenzime jointeresi ndaj të ardhurave bruto	49.21	51.47	54.59	Noninterest expenses to gross income
Të tjera				Other
Numri i bankave	11.00	11.00	11.00	Number of banks

Burimi: Banka e Shqipërisë

Source: Bank of Albania